



P.nr.3107/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi , me zyrtares ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2306-4/17, e dt. 11.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt. 12.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP/II.nr.2306-4/17, e dt. 11.12.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna .Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend , nga i ati [REDACTED], Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me dt. 21.10.2017 rreth orës 15:00 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për buqësi dhe pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik pyjor në fsh.Neredime-Jezercë në vendin e quajtur “te Rrafshi i Bylmetit”, me qëllim vjedhje ka prerë 1 drunjë të llojit ahut me diametër 70cm në gjatësi Boniteti –III gjithsejtë në karburantë prej 4.49m³, të cilat i ka transportuar me traktor IMT-39 me rimokio, vlera e dëmit të shkaktuar është 606.15Euro.

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **200€ (dyqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 30 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzet/euro) të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i pandehuri që të bëjë kompensimin e dëmit të dëmtuarës DBP /Drejtorisë Bujqësisë dhe Pylltarisë në Ferizaj që të paguaj shumën prej 606.15 €/ gjashtëqind euro e gjashtë euro e pesëmbëdhjetë cent/

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **20€ (njëzet/euro)**, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej **30€(tridhjetë/euro)**, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP/II.nr.2306-4/17, e dt. 11.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] KK Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi

penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e dëmit është marr në kuptim të nenit 458,459 dhe 460 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.3107/17 e dt. 12.03.2018

Sekretarja juridike

Ganimete Avdiu

Gjyqtari i vetëm gjykues

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.